**RELACION SHPJEGUES**
**PËR PROJEKTLIGJIN**
**"PËR ZHVILLIMIN E NDËRMARRJEVE MIKRO, TË VOGLA DHE TË MESME"**

## I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN.

Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë ka hartuar projektligjin "Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme", me qëllim rritjen e mbështetjes së biznesit për të forcuar konkurrueshmërinë e tyre dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Deri më sot, ka patur një interes të ulët në skemat e bashkëfinancimit të AIDA, për shkak të mungesës së informacionit nga bizneset, mënyra e aplikimit e cila ka qenë nëpërmjet postës dhe jo në formë elektronike, mungesa e shërbimeve mbështetëse për biznesin etj. Për këtë është vlerësuar shumë i nevojshëm rishikimi i kuadrit ligjor për mbështetjen e ndërmarrjeit për të qenë koherent me nevojat e tij. Asnjë mbështetje financiare direkte nuk ekziston në formën e granteve për kërkime dhe zhvillim (R&D), për më tepër mungojnë programet për të financuar drejtpërsëdrejti bashkëpunimin e ndërmarrjeve dhe akademisë edhe pse si ndërmarrjet si organizatat kërkimore kanë të drejtë të aplikojnë për thirrje për propozime pranë Agjencisë Kombëtare për Kërkim, Teknologji dhe Inovacion (të cilat janë të kufizuara në shumën e fondeve të ofruara për shkak të alokimeve të ulëta të buxhetit të shtetit). Referuar draft Raportit të Monitorimit të SEE 2020 të RCC për vitin 2019-2020, raportohet se gjënden statistika të besueshme dhe gjithëpërfshirëse për kërkimin, zhvillimin dhe inovacionin (R&D dhe Inovacion) në shtetet e rajonit si Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë, ndërkohe që tre ekonomitë e tjera të ËB (Shqipëri, Kosovë dhe Bosnjë-Herzegovinë) nuk kanë bërë asnjë përparim në këtë fushë.
Ekzistenca e mangësive ligjore për dhënien e fondeve nga AIDA për bizneset. Që prej vitit 2019, Ministria e Drejtësisë është shprehur kundër miratimit të projektvendimit të KM të propozuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, lidhur me krijimin dhe zbatimin e Fondit të Konkurrueshmërisë. Konkretisht dispozitat e referuara në projektakt nuk autorizojnë shprehimisht Këshillin e Ministrave për të nxjerrë një projektvendim me përmbajtje të tillë.

Objektivat dhe rezultatet e synuara të projektaktit janë:
- Rritja e mbështetjes për NMVM-të me 50 %;
- Rritja e aplikimeve për teknologji të reja nga zero aktualisht në 50 % brenda vitit 2022.
- Rritja çdo vit e numrit të ndërmarrjeve të reja me , rritja e numrit të të punësuarve si edhe futja e instrumenteve të reja financiare me 10 %. respektivisht për cdo tregues;
- Rritja e shkallës e përthithjes së granteve me 100 % nga bizneset

## II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE.

Projekt akti nuk është pjesë e programit analitik të akteve të parashikuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Projektakti është në përputhje me programin politik të Qeverisë për nismat ligjore dhe nënligjore që duhen ndërmarrë për të përgatitur dhe zbatuar politikat e qeverisë për zhvillimin ekonomik.

## III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME.

Projektakti mundëson krijimin e një një kuadri ligjor dhe institucional më të plotë, i cili iu përgjigjet nevojave të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme. Masat mbështetëse për NMVM do të mirë përcaktohen me ligj, për të gjitha ndërmarrjet pavarësisht sektorëve ku operojnë. Në veçanti, referencat e reja ligjore që do të ngarkojnë organin e Këshillit të Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore të mbeshtetjes së biznesit, duke adresuar të gjitha problematikat ligjore të hasura deri më sot, si edhe do të lehtësojë hartimin e politikave mbështetëse për ndërmarrjet dhe ecosistemin bizneseve në vend.

Për herë të parë, mbështetja shtetërore për NMVM është e strukturuar në format si vijon:

- Mbështetje financiare nga buxheti i shtetit
- Mbështetje financiare nga donatorët vendas apo të huaj ;
- Garanci shtetërore të huasë sipas ligjit në fuqi për borxhin dhe garancitë shtetërore, në zbatim të politikave të veçanta të Qeverisë, në përputhje me parimet dhe rregullat fiskale mbi qëndrueshmërinë e borxhit publik si dhe kufizimet e borxhit shtetëror dhe të garancive shtetërore të huave;
- Shërbime publike për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, sipas përcaktimeve në këtë ligj;

Draft ligji përcakton detyrimin e Agjensisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve për të administruar një portal elektronik për instrumentet financiare të krijuara me fonde nga buxheti i shtetit dhe me donatorë. Cdo institucion që ofron mbështetje financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme ngarkohet që brenda 5 ditëve përpara filllimit të zbatimit të skemës të paraqesë një informacion pranë AIDA.
MFE ka vlerësuar se zbatimi i kuadrit ligjor ekzistues, konkretisht ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, "Për ndermarrjet e vogla dhe te mesme", i ndryshuar, ka patur mungesa të hapësirave ligjore për hartimin e skemave të garancisë shtetërore të huasë, për mbështetetjen e kreditimit të ndërmarrjeve, dhe për më tëpër nuk mundëson rregullimin e plotë të bazës ligjore për ofrimin e shërbime publike për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, sipas përcaktimeve në këtë ligj.

Më këtë projektakt sigurohet dhënia e mbështetjes shtetërore nëpërmjet ofrimit të shërbimeve mbështetëse do të konsistojë në: 1)Sigurimin e informacionit, 2) këshillimit, 3) zhvillimit të biznesit, 4) trajnimit, 5) zhvillimit profesional apo ritrajnimit, 6) dhënien e shërbimeve metodologjike për ndërmarrjet si edhe personave fizikë që synojnë të krijojnë një ndërmarrje; si dhe 6) cdo informacion tjetër për mbështetjen dhe zhvillimin e ndërmarrjeve.

## IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR.

Projektakti hartohet në bazë të neneve 81, pika 1, dhe 100 të Kushtetutës.

## V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUITAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektakti synon përputhjen me dispozitat e legjislacionit parësor dhe dytësor të BE-së. Shkalla e përfarimit është e pjesshme.

## VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Në Nenin 1, të projektaktit përcaktohen rregullat për masat dhe politikat shtetërore për klasifikimin, nxitjen e krijimit dhe të zhvillimit të ndërmarrjeve.

Në Nenin 2, të projektaktit jepet qëllimi i këtij ligji, i cili është të përcaktojë përkufizimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme të përdorur në politikat shtetërore për t'i mbështetur ato, si dhe politikat shtetërore, kuadrin institucional dhe rregullator në ndihmë të ndërmarrjeve

Në Nenin 3, të projektaktit jepen përkufizimet kryesore.

Në nenin 4, të projektaktit përcaktohen rregullat për përcaktimin e kategorive të ndërmarrjeve nisur nga numri i punonjësve dhe tavaneve financiare. Konkretisht:

Ndërmarrjet klasifikohen në: mikrondërmarrje, ndërmarrje të vogla dhe ndërmarrje të mesme, në vijim NMVM.

- Kategoria e mikrondërmarrjeve dhe ndërmarrjeve të vogla e të mesme (NMMV) përfshin ato ndërmarrje, ku punësohen më pak se 250 veta dhe që realizojnë një shifër afarizmi dhe/ose një bilanc total vjetor jo më të madh se 250 milionë lekë.
- Ndërmarrje e vogël quhet një ndërmarrje, ku punësohen më pak se 50 persona dhe e cila ka një shifër afarizmi dhe/ose bilanc total vjetor jo më të madh se 50 milionë lekë.
- Mikrondërmarrje quhet një ndërmarrje, ku punësohen më pak se 10 persona dhe e cila ka një shifër afarizmi dhe/ose bilanc total vjetor jo më të madh se 10 milionë lekë.
- Për qëllime statistikore ndërmarrjet do të klasifikohen në:
  a) mikrondërmarrje: 0 deri 9 persona, ku brenda këtij grupimi të detajohen në 0-1 persona dhe 2-9 persona;
  b) ndërmarrje të vogla: 10 deri 49 persona;
  c) ndërmarrje të mesme: 50 deri 249 persona.

Në Nenin 5, të projekaktit, përcaktohen llojet e ndërmarrjeve që konsiderohen për llogaritjen e numrit të stafit dhe vlerës financiare. Konkretisht:

1. "Ndërmarrje autonome" është çdo ndërmarrje, e cila nuk zotëron, e vetme ose bashkërisht me një ose më shumë ndërmarrje të lidhura, 25% ose më shumë të kapitalit ose të të drejtave të votës së një ndërmarrje tjetër. Ndërmarrja autonome nuk është e lidhur me një ndërmarrje tjetër në asnjë nga format e parashikuara në pikën 3 të këtij neni.
2. "Ndërmarrje partnere" janë të gjitha ndërmarrjet që nuk klasifikohen si ndërmarrje të lidhura në kuptim të pikës 3, të ketij neni dhe midis të cilave ekziston marrëdhënia si vijon: një ndërmarrje zotëron, ose vetëm ose së bashku me një ose më shumë ndërmarrje të lidhura në kuptim të pikës 3, të këtij neni, 25 % ose më shumë të kapitalit ose të drejtave të votës të një ndërmarrje tjetër.

2.1 Një ndërmarrje mund të jetë autonome, duke mos patur ndërmarrje partnere, edhe nëse pragu prej 25% plotësohet ose tejkalohet nga investitorët që renditen si vijon, me kusht që këta investitorë të mos jenë të lidhur, në kuptim të pikës 3, të këtij neni, ose individualisht ose bashkarisht me ndërmarrjen në fjalë:

a. korporatat publike të investimeve, shoqëritë e kapitalit sipërmarrës, individët ose grupet e individëve me aktivitet të rregullt në investimet e kapitalit sipërmarrës, të cilët investojnë kapitalin e vet në ndërmarrje të palistuara *(business angels)*, me kusht që investimi total i biznesve të palistuara në të njëjtën ndërmarrje të jetë më pak se 30,000,000 Lekë;
b. institucionet e arsimit të lartë ose qendra jofitimprurëse kërkimore;
c. investitorët institucionalë, përfshirë fondet rajonale të zhvillimit;
ç. njësitë e vetqeverisjes vendore me një buxhet vjetor me më pak se 10 milion EUR dhe më pak se 5000 banorë.

3. "Ndërmarrje të lidhura" janë ndërmarrjet që kanë një nga lidhjet e mëposhtme:

a) një ndërmarrje ka shumicën e të drejtave të votave të aksionarëve ose anëtarëve në një ndërmarrje tjetër;
b) një ndërmarrje ka të drejtë të emërojë ose largojë shumicën e anëtarëve të organeve administrative, menaxhuese ose mbikëqyrëse të një ndërmarrje tjetër;
c) një ndërmarrje ka të drejtë të ushtrojë një ndikim dominues mbi një ndërmarrje tjetër, në bazë të një kontratë të lidhur me atë ndërmarrje ose të një përcaktimi në memorandum apo nenet e statutit;
ç) një ndërmarrje, e cila është aksionare ose anëtare e një ndërmarrje tjetër, kontrollon e vetme, në përputhje me një marrëveshje me aksionarët e tjerë ose anëtarët e asaj ndërmarrjeje, shumicën e të drejtave të votave të aksionarëve ose anëtarëve në atë ndërmarrje.

3.1 Prezumohet se nuk ekziston asnjë ndikim dominues nëse investitorët e renditur në pikën 2.1 nuk përfshihen direkt ose indirekt në menaxhimin e ndërmarrjes në fjalë, pa paragjykuar të drejtat e tyre si aksionere.

3.2 Ndërmarrjet që kanë një nga marrëdhëniet e përshkruara në pikën 3 me një ose më shumë ndërmarrjeve të tjera, ose ndonjë prej investitorëve të përmendur në pikën 2, konsiderohen se janë të lidhura.

3.3 Ndërmarrjet të cilat kanë që kanë një apo më shumë marrëdhenie përmes një personi fizik ose një grupi personash fizikë që veprojnë së bashku konsiderohen gjithashtu ndërmarrje të lidhura, nëse ato ushtrojnë aktivitetin e tyre ose një pjesë të aktivitetit të tyre në të njëjtin treg ose në tregjet e lidhura.

4. Me përjashtim të rasteve të përcaktuara në pikën 2.1, të këtij neni, një ndërmarrje nuk mund të konsiderohet NMVM nëse 25 % ose më shumë e kapitalit ose të drejtat e votës kontrollohen drejtpërdrejt ose indirekt, bashkërisht ose individualisht, nga një ose më shumë organe publike.

5. Ndërmarrjet mund të bëjnë një deklaratë të statusit si një ndërmarrje autonome, ndërmarrje partnere ose ndërmarrje e lidhur, duke përfshirë të dhënat në lidhje me tavanet e përcaktuara në nenin 2. Deklarata mund të bëhet edhe nëse kapitali është i shpërndarë në një mënyrë të tillë që nuk është e mundur të përcaktohet saktësisht se prej kujt zotërohet. Në këtë rast ndërmarrja mund të deklarojë në mirëbesim se prezumon në mënyrë të rregullt se nuk zotërohet në (masën) 25% ose më shumë nga një ndërmarrje ose nga disa ndërmarrje bashkarisht të lidhura me

njëra-tjetrën. Deklarata të tilla kryhen pavarësisht kontrolleve dhe hetimeve të përcaktuar në legjislacionin përkatës.

6. Mënyra e deklarimit të llojit të ndërmarrjes, sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij neni, përcaktohet me udhëzim të miratuar nga ministri përgjegjës për ekonominë.

Në nenin 6, të projektaktit përcaktohen se cilat janë të dhënat që përdoren për llogaritjen e numrit të personelit dhe shumat financiare dhe periudha e raportimit

Në neni 7, të projektaktit përcaktohet se cili është numri i personelit për periudhën e raportimit, me qëllim kategorizimin e ndërmarrjeve.

Në nenin 8, të projektaktit përcaktohen rregullat për mënyrën e krijimit të të dhënave për ndërmarrjen. Gjithashtu është përcaktuar se ministri përgjegjës për ekonominë do të nxjerrë udhëzimin në zbatim të këtij neni.

Në kreun II, të projektaktiti janë parashikuar format e mbështetjes shtetërore për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme

Në nenin 9, të projektaktit është përcaktuar se rregullat e dhënies së mbështetjes shtetërore për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, si vijon:

- Dhënia e mbështetjes shtetërore, në zbatimin e disa politikave mbështetëse për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, pavarësisht përcaktimeve të bëra në nenin 4, të këtij ligji, mund të konsiderohet vetëm kriteri i numrit të personelit, por në përputhje me rregullat për ndihmën shtetërore.

- Ndihma shtetërore dhe ndihma "*de minimis*" jepet në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën shtetërore.

- Mbështetja për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme duhet të garantojë akses të balancuar gjinor.

Në nenin 10, të projekaktit janë përcaktuar format e mbështetjes shtetërore për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, si vijon:

Format e mbështetjes shtetërore që jepen për ndërmarrjet e mikro, të vogla dhe të mesme përfshijnë kryesisht:

a. Mbështetje financiare nga buxheti i shtetit
b. Mbështetje financiare nga donatorët vendas apo të huaj ;
c. Garanci shtetërore të huasë sipas ligjit në fuqi për borxhin dhe garancitë shtetërore, në zbatim të politikave të veçanta të Qeverisë, në përputhje me parimet dhe rregullat fiskale mbi qëndrueshmërinë e borxhit publik si dhe kufizimet e borxhit shtetëror dhe të garancive shtetërore të huave;
d. Shërbime publike për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, sipas përcaktimeve në këtë ligj;

Në nenin 11, të projektaktit është përcaktuar mënyra, qëllimi, kriteret, dhe strukturat që do të mundësojnë dhënien e mbështetjes financiare buxhetore, si vijon:

1. Për mbështetjen dhe zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, sipas shkronjës a), të pikës 1, të nenit 10 të këtij ligji, krijohet fondi për zhvillimin e ndërmarrjeve, në formën e granteve nga buxheti e shtetit.
2. Fondi përdoret për dhënien e granteve për NMVM për zbatimin e programeve që synojnë rritjen e konkurrueshmërisë, artizanatit, zhvillimin e të mësuarit rreth ndërmarrjes, zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve të reja si rezultat i kërkim-zhvillimit, aksesin në burime financiare, zhvillimin e aftësive të ndërmarrjes, inovacionin, dhe ndërkombëtarizimin dhe zhvillimin e NMVM.
3. Fondi për zhvillimin e ndërmarrjeve administrohet nga Agjensia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA).
4. Procedura konkuruese, krijimi, funksionimi, shpërblimi dhe organizimi i bordit vlerësues të aplikimeve, përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.
5. Kriteret e përgjithshme të përfitimit të mbështetejes financiare buxhetore për NMVM janë:

   a) të jenë person fizik apo juridik i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, për jo më pak se 6 (gjashtë) muaj;

   b) të mos jenë në proces falimentimi;

   c) të kenë paguar rregullisht sigurimet e detyrueshme shëndetësore dhe shoqërore;

   ç) të mos kenë detyrime ndaj organeve doganore dhe tatimore, në momentin e aplikimit për fond.

   d)të ketë dorezuar Deklaratën sipas nenit 5,6 dhe 7 të këtij ligji

6. Përcaktimi i masës së përfitimit dhe kriteret dhe kushtet e veçanta të përfitimit për NMVM përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, rast pas rasti.
7. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) administron një portal elektronik për instrumentet financiare të krijuara me fonde nga buxheti i shtetit dhe me donatorë. Çdo institucion që ofron mbështetje financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme ngarkohet që brenda 5 ditëve përpara filllimit të zbatimit të skemës të paraqesë informacion pranë AIDA.

Në nenin 12, të projektaktit është parashikuar dhënia e garancitë shtetërore të huasë. Në rastet kur, për të mbështetur kreditimin e ndërmarrjeve, në zbatim të politikave të veçanta të Qeverisë, vendoset të lëshohet garanci shtetërore, Këshilli i Ministrave me vendim përcakton fondin, sektorët, kushtet dhe kriteret, për garantimin e huasë për mbështetjen e ndërmarrjeve, me propozim të ministrit përgjegjës për financat dhe ministrit përgjegjës për ekonominë.

Në neni 13, të projektaktit është parashikuar procedura për dhenien e mbështetjes financiare për ndërmarrjet nga njësitë e vetqeverisjes vendore, të cilat kur japin mbështetje shtetërore financiare duhet të përcaktojnë qartë procedurën për ofrimin e mbështetjes për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, procedurë e cila duhet të jetë e njëjtë për të gjitha ndërmarrjet që përfitojnë mbështetjen shtetërore.

Në nenin 14, të projektaktit janë përcaktuar si cilat janë shërbimet publike për ndërmarrjet, si vijon:

1. Shërbimet publike jepen nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve dhe përfshijnë kryesisht:
   a. Sigurimin e informacionit, këshillimit, zhvillimit të biznesit, trajnimit, zhvillimit profesional apo ritrajnimit, dhënien e shërbimeve metodologjike për ndërmarrjet si edhe personave fizikë që synojnë të krijojnë një ndërmarrje;
   b. Çdo informacion tjetër për mbështetjen dhe zhvillimin e ndërmarrjeve.
2. Shërbimet publike sipas pikës 1, të këtij neni sigurohen nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Dhënia e shërbimeve publike për ndërmarrjet përballohet nga fondi i buxhetit, brenda tavaneve buxhetore të alokuara për Agjencinë Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për mbështetjen e ndërmarrjeve, sipas legjislacionit në fuqi.
4. Hartimi i skemave të mbështetjes së ndërmarrjeve mund të përfshijë kombinimin e mbështetjes shtetërore financiare sipas pikës 3 të nenit 11 të këtij ligji me ofrimin e shërbimeve publike sipas pikës 1 të këtij neni.
5. Përcaktimi i masës së përfitimit dhe kriteret dhe kushtet e veçanta të përfitimit për NMVM përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, rast pas rasti.

Në nenin 15, të projekaktit janë përcaktuar autoritetet përgjegjëse për zhvillimin e ndërmarrjeve.

Në nenin 16, të projektaktit është përcaktuar mënyra e hartimit të raporteve vjetore nga ana e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve

Në nenin 17, të projektaktit është përcaktuar referenca ligjore për hartimin e strategjisë së zhvillimit të biznesit dhe investimeve.

Në nenin 18, të projektaktit është përcaktuar se cilat janë burimet e financimit të strategjisë.

Në Kreun III, të projekaktit është parashikuar ngritja dhe funksionimi i këshillit për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme

Në nenin 19, të projektaktit është parashikuar qëllimi, përbërja dhe detyrat e Këshillit konsultativ për ndërmarrjet, si vijon:

1. Këshilli Konsultativ për ndërmarrjet është organ këshillimor që ngrihet pranë institucionit përgjegjës për ekonominë, me përfaqësimin e organizatave të biznesit si edhe institucioneve shtetërore.
2. Këshilli kryesohet nga ministria përgjegjës për ekonominë dhe përbëhet nga 12 anëtarë si më poshtë:
   a) 1 përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financat;
   b) 2 përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet e ekonomisë;
   c) 1 përfaqësues nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen e sipërmarrjes;
   d) 1 përfaqësues nga Agjensia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve;
   e) 1 përfaqësues nga Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë;
   f) 1 përfaqësues nga Qëndra Kombëtare e Biznesit;
   g) 2 përfaqësues të sipërmarrjes dhe biznesit, të përzgjedhur nga organizatat dhe dhomat më të përfaqësuara të tregtisë dhe biznesit;

h) 2 përfaqësues të institucioneve të arsimit të lartë, nga të cilët një përfaqësues nga institucionet publike të arsimit të lartë dhe një përfaqësues nga institucionet jopublike të arsimit të lartë;
i) 1 përfaqësues nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, i propozuar nga Shoqata e Bashkive të Shqipërisë.

3. Anëtarët e Këshillit emërohen me urdhër të ministrit, pas propozimit nga institucionet/organizatat e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, për një mandat 3-vjeçar.
4. Përzgjedhja e organizatave më të përfaqësuara të biznesit dhe organizatave që mbështesin biznesin bëhet nga ministri Këshilli Konsultativ për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme ushtron kompetencat e mëposhtme:
   a. diskuton çështjet që lidhen me mbështetjen dhe zhvillimin e biznesit;
   b. nxit bashkëpunimin efektiv ndërmjet organizatave të biznesit/organizatave që mbështesin biznesin dhe organeve shtetërore;
   c. këshillon lidhur me mënyrën e hartimit të skemave mbështetëse për biznesin, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe strategjisë sipas përcaktimit në nenin 18 të këtj ligji.
5. Rregulla për organizimin, funksionimin dhe kompetencat dhe shpërblimin e Këshillit për ndërmarrjet përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Këshilli Konsultativ për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme do të këshillojë ministrinë përgjegjëse për ekonominë për hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të biznesit dhe investimeve, për prioritizimin e tyre dhe orientimin e duhur në periudhë afat shkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë.

## VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ AKTI.

Për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

## VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKT-AKTIT.

Projektvendimi është përgatitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Projekt akti do të dërgohet për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministrinë për Mbështejen e Sipërmarrjes, Ministrinë e Shtetit për Diasporën, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Ministrinë e Kulturës, Ministrinë Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrin e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Ministrinë Për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Njësinë e Vetqeverisjes Vendore.

## IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE.

Në këtë projektakt janë llogaritur si kosto për buxhetin e shtetit kostot e parashikuara në Strategjinë e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021-2027, për mbështetjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, në formën e mbështetjes financiare (grante) dhe shërbime mbështetëse

(trajnim, këshillim). Në vitin e parë janë parashikuar kosto gjithsej 13,012,733 lekë, e cila përfshin organizimin e ëebinareve për zhvillimin e "e-business", krijimin e Sektorit të Trajnimeve pranë AIDA me 3 punonjës të rinj në strukturën e AIDA, zhvillimin e sistemit të parashikimit të aftësive për bizneset. Në vitin e dytë janë parashikuar kosto gjithsej 99,369,454 lekë, e cila përfshin krijimin e portalit për zhvillimin e e-business (nga AIDA), i cili do të ndihmojë bizneset në përzgjedhjen e formave më të mira të tregtisë elektronike dhe të biznesit elektronik ("e-commerce" dhe "e-business" solutions), grante për ofrimin e trajnimeve dhe mbështetje financiare për ndërmarrjet e sapokrijuara, grante për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, si edhe hartimin e raporteve vjetore për parashikimin e nevojave për aftësim nga bizneset. Duke filluar nga viti i tretë deri në vitin e dhjetë janë parashikuar kosto gjithsej 93,369,545 lekë, të cilat përfshijnë dhënien e mbeshtetjes financiare (grante) si edhe shërbime mbështetëse për biznesin. Drejtoria e Poltikave te Zhvillimit Ekonomik si përgjegjëse e hartimit të politikave mbështetëse për biznesin ka kuantifikuar përfitimet për bizneset në direkte (grantet) dhe indirekte (organizimi i trajnimeve, zhvillimi i aftesive etj). Parimi i "*Value for money*" është përdorur për llogaritjen e eficencës dhe efektivitetit maksimale për çdo lekë të planifikuar dhe shpenzuar nga buxheti i shtetit (me shkallën e përfitimit nga biznesi që pritet të jetë maksimale në 100 %).

**MINISTËR**

**Anila DENAJ**

**Tabela e përputhshmërisë**

Rekomandimi i Komisionit 2003/361/EC në lidhje me përkufizimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme

| Acquis e BE-së<br>Rekomandimi i Komisionit i 6 majit 2003 në lidhje me përkufizimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (njoftuar nën numrin e dokumentit C (2003) 1422)<br>OJ L 124, 20.5.2003, f. 36–41 | | **Legjislacioni shqiptar**<br>0.1 Projektligji "Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme"<br><br>F - përputhshmëri e plotë<br>P – përputhshmëri e pjesshme<br>N/a – i papërputhur | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 |
| Neni | Teksti | Referenca | Neni | Teksti | Përputhshmëria | Shënime |
| Neni 1<br>Paragrafi 1 | 1. Ky Rekomandim ka të bëjë me përkufizimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme të përdorura në politikat e Komunitetit të zbatuara brenda Komunitetit dhe Zonës Ekonomike Evropiane. | n/a | n/a | n/a | n/a | Kjo dispozitë është përafruar. Jepet objekti e Rekomandimit. |
| Neni 1<br>Paragrafi 2 | 2. Shtetet Anëtare, Banka Evropiane e Investimeve (EIB) dhe Fondi Evropian i Investimeve (EIF), ftohen:<br>(a) të jenë në përputhje me Titullin I të Shtojcës 1 tëpër programin dhe gomën drejtuar ndërmarrjet e mesme, ndërmarrjet e vogla ose ndërmarrjet e vogla;<br>(b) për të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të përdorur klasat e madhësisë të përcaktuara në Nenin 7 të Shtojcës, kur bëhet fjalë për monitorimin e përdorimit të tyre për instrumenteve financiare të Komunitetit. | n/a | n/a | n/a | n/a | Kjo dispozitë zbatohet vetëm për Shtetet Anëtare. Sidoqoftë, ajo do të zbatohet për Shqipërinë në datën e anëtarësimit. |
| Neni 2 | Tavanet e paraqitura në Nenin 2 të Aneksit do të konsiderohen si vlera maksimale. Shtetet Anëtare, EIB dhe EIF mund të përcaktojnë tavanet më të ulëta. Në zbatimin e disa politikave të tyre, ata gjithashtu mund të zgjedhin të zbatojnë vetëm kriterin e numrit të të punësuarve, përveç në fushat e rregulluara nga rregullat e ndryshme të ndihmës shtetërore. | n/a | n/a | n/a | n/a | Kjo dispozitë nuk ka ndonjë lidhje me përafrimin. Ky nen siguron një udhëzim se si të transpozohet dhe zbatohet Rekomandimi. |
| Neni 3 | Ky Rekomandim do të zëvendësojë Rekomandimin 96/280 / EC nga 1 Janari 2005. | n/a | n/a | n/a | n/a | Kjo dispozitë nuk ka ndonjë lidhje me përafrimin. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Neni 4 | Ky Rekomandim i drejtohet Shteteve Anëtare, BEI dhe EIF.<br>Atyre iu kërkohet të informojnë Komisionin deri më 31 Dhjetor 2004 për çdo masë që kanë marrë më tej dhe, jo më vonë se 30 Shtator 2005, për ta informuar atë për rezultatet e para të zbatimit të tij. | n/a | n/a | n/a | n/a | Kjo dispozitë zbatohet vetëm për Shtetet Anëtare. Sidoqoftë, ajo do të zbatohet për Shqipërinë deri në datën e pranimit. |
| Shtojcë | Titulli I<br>Përkufizimi i ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme të miratuara nga Komisioni. | | | | | |
| Neni 1<br>Ndërmarrje | Një ndërmarrje konsiderohet të jetë çdo subjekt i angazhuar në një aktivitet ekonomik, pavarësisht nga forma e saj ligjore. Kjo përfshin, në veçanti, personat e vetëpunësuar dhe bizneset familjare të angazhuara në zeje ose veprimtari të tjera, dhe partneritetet ose shoqatat që rregullisht merren me një aktivitet ekonomik. | 0.1. | Neni.3<br>Përkufizimet<br>Para. 1 | "Ndërmarrje" quhet çdo subjekt që ushtron një veprimtari ekonomike, pavarësisht formës së tij ligjore. Këtu përfshihen personat e vetëpunësuar, bizneset familjare, që merren me artizanat ose veprimtari të tjera, si dhe shoqëritë e shoqatat që kryejnë në mënyrë të rregullt veprimtari ekonomike. | F | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Neni 2<br>Numri i personelit dhe tavanet financiare që përcaktojnë kategoritë e ndërmarrjeve<br>Paragrafi 1 | 1. Kategoria e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NVM) përbëhet nga ndërmarrje të cilat punësojnë më pak se 250 persona dhe të cilat kanë një qarkullim vjetor jo më shumë se 50 milion EUR, dhe / ose një bilanc vjetor jo më të madh se EUR 43 milion | 0.1. | Neni. 4<br>Para. 2. | 2. Kategoria e mikrondërmarrjeve dhe ndërmarrjeve të vogla e të mesme (NMVM) përfshin ato ndërmarrje, ku punësohen më pak se 250 persona dhe që realizojnë një shifër afarizmi dhe/ose një bilanc total vjetor jo më të madh se 250 milionë lekë.. | P | Përkufizimi në shqip i NVM-ve është në përputhje me rekomandimin në lidhje me numrin e personave të punësuar. Nuk është në përputhje me rekomandimin në lidhje me përkufizimin në lidhje me shumën e bilancit total vjetor: arsyeja për përcaktimin e një shume më të vogël se 43 milion EUR lidhet me madhësinë e ekonomisë shqiptare. |
| Neni 2<br>Numri i punonjësve dhe tavanet financiare që përcaktojnë kategoritë e ndërmarrjeve<br>Paragrafi 2 | 2. Brenda kategorisë së NVM-ve, një ndërmarrje e vogël përcaktohet si një ndërmarrje e cila punëson më pak se 50 persona dhe qarkullimi vjetor dhe / ose bilanci vjetor i së cilës nuk i kalon 10 milion EUR. | 0.1. | Neni. 4<br>Para. 3. | 3.Ndërmarrje e vogël quhet një ndërmarrje, ku punësohen më pak se 50 persona dhe e cila ka një shifër afarizmi dhe/ose bilanc total vjetor jo më të madh se 50 milionë lekë. | P | Përkufizimi në shqip i ndërmarrjes së vogël është në përputhje me rekomandimin në lidhje me numrin e personave të punësuar. Nuk është në përputhje me rekomandimin në lidhje me përkufizimin në lidhje me shumën e bilancit total vjetor: arsyeja për caktimin e një shume më të vogël se 10 milion EUR lidhet me madhësinë e ekonomisë shqiptare. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Neni 2<br>Numri i punonjësve dhe tavanet financiare që përcaktojnë kategoritë e ndërmarrjeve<br>Paragrafi 3 | 3. Brenda kategorisë së NVM-ve, një ndërmarrje e vogël përcaktohet si një ndërmarrje e cila punëson më pak se 10 persona dhe qarkullimi vjetor dhe / ose bilanci vjetor i të cilit nuk kalon 2 milion EUR. | 0.1. | Neni.4<br>Para. 4. | 4. Mikrondërmarrje quhet një ndërmarrje, ku punësohen më pak se 10 persona dhe e cila ka një shifër afarizmi dhe/ose bilanc total vjetor jo më të madh se 10 milionë lekë. | P | Përkufizimi në shqip i ndërmarrjes së vogël është në përputhje me rekomandimin në lidhje me numrin e personave të punësuar. Nuk është në përputhje me rekomandimin në lidhje me përkufizimin në lidhje me shumën e bilancit total vjetor: arsyeja për përcaktimin e një shume më të vogël se 2 milion EUR lidhet me madhësinë e ekonomisë shqiptare. |
| Neni 3<br>Llojet e ndërmarrjeve të marra në konsideratë gjatë llogaritjes së personelit dhe shumave financiare<br>Paragrafi 1 | 1. "Ndërmarrje autonome" është çdo ndërmarrje e cila nuk klasifikohet si ndërmarrje partnere në kuptimin e paragrafit 2 ose si ndërmarrje e lidhur brenda kuptimit të paragrafit 3. | 0.1. | Neni. 5<br>Para. 1 | 1."Ndërmarrje autonome" është çdo ndërmarrje, e cila nuk zotëron, e vetme ose bashkërisht me një ose më shumë ndërmarrje të lidhura, 25% ose më shumë të kapitalit ose të të drejtave të votës së një ndërmarrje tjetër. Ndërmarrja autonome nuk është e lidhur me një ndërmarrje tjetër në asnjë nga format e parashikuara në pikën 3 të këtij neni. | F | |
| Neni 3<br>Llojet e ndërmarrjeve të marra në konsideratë gjatë llogaritjes së numrit të stafit dhe shumave financiare<br>Paragrafi 2 | 2. "Ndërmarrje partnere" janë të gjitha ndërmarrjet që nuk klasifikohen si ndërmarrje të lidhura brenda kuptimit të paragrafit 3 dhe midis të cilave ekziston marrëdhënia e mëposhtme: një ndërmarrje (ndërmarrje e sipërme) mban, ose vetëm ose bashkërisht me një ose më shumë ndërmarrje të lidhura brenda kuptimi i paragrafit 3, 25% ose më shumë të kapitalit ose të drejtave të votës së një ndërmarrje tjetër (ndërmarrje në rrjedhën e poshtme). | 0.1. | Art. 5<br>Para.2 | 2."Ndërmarrje partnere" janë të gjitha ndërmarrjet që nuk klasifikohen si ndërmarrje të lidhura në kuptim të pikës 3, të ketij neni dhe midis të cilave ekziston marrëdhënia si vijon: një ndërmarrje zotëron, ose vetëm ose së bashku me një ose më shumë ndërmarrje të lidhura në kuptim të pikës 3, të këtij neni, 25 % ose më shumë të kapitalit ose të drejtave të votës të një ndërmarrje tjetër. | F | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Neni 3<br>Llojet e ndërmarrjeve të marra në konsideratë në llogaritjen e numrit të stafit dhe shumave financiare<br>Paragrafi 2 | Sidoqoftë, një ndërmarrje mund të renditet si autonome, dhe kështu që nuk ka ndonjë ndërmarrje partnere, edhe nëse ky prag prej 25% arrihet ose tejkalohet nga investitorët e mëposhtëm, me kusht që ata investitorë të mos jenë të lidhur, në kuptimin e paragrafit 3, ose individualisht ose bashkarisht në ndërmarrjen në fjalë:<br>(a) korporatat e investimeve publike, kompanitë e kapitaleve sipërmarrëse, individët ose grupet e individëve me një aktivitet të rregullt të investimeve të kapitalit sipërmarrës të cilët investojnë kapital të vet në biznese të pakotifikuara ("engjëj biznesi"), me kusht që investimi total i atyre engjëjve të biznesit në të njëjtën ndërmarrje të jetë më pak se 1250000 EUR;<br>(b) universitete ose qendra hulumtuese jofitimprurëse;<br>(c) investitorët institucionalë, përfshirë fondet e zhvillimit rajonal;<br>(d) autoritetet lokale autonome me një buxhet vjetor prej më pak se 10 milion EUR dhe më pak se 5000 banorë. | 0.1. | Art. 5<br>Para. 2.1 | Një ndërmarrje mund të jetë autonome, duke mos patur ndërmarrje partnere, edhe nëse pragu prej 25% plotësohet ose tejkalohet nga investitorët që renditen si vijon, me kusht që këta investitorë të mos jenë të lidhur, në kuptim të pikës 3, të këtij neni, ose individualisht ose bashkarisht me ndërmarrjen në fjalë:<br>a. korporatat publike të investimeve, shoqëritë e kapitalit sipërmarrës, individët ose grupet e individëve me aktivitet të rregullt në investimet e kapitalit sipërmarrës, të cilët investojnë kapitalin e vet në biznese të palistuara (business angels), me kusht që investimi total i biznesve të palistuara në të njëjtën ndërmarrje të jetë më pak se 30,000,000 Lekë;<br>b. institucionet e arsimit të lartë ose qendra jofitimprurëse kërkimore;<br>c. investitorët institucionalë, përfshirë fondet rajonale të zhvillimit;<br>ç. njësitë e vetqeverisjes vendore me një buxhet vjetor me më pak se 10 milion EUR dhe më pak se 5000 banorë. | P | Pragu i investimeve të engjëjve të biznesit është më i ulët se ai i BE-së, duke pasur parasysh madhësinë e ekonomisë së Shqipërisë (investime në kapital privat). |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
